



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT**

**VENDIM**

Nr.26, datë 12/10/2022

**PËR**

**MBI KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR.13  
DATË 07.08.2020 DHE LEJES ME NR SERIE 00039 “PËR  
MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM  
BURIMI UJOR” SHOQËRISË “KOKA&ERGI ENERGY  
STAVEC” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/auforizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 e 2, neni 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” I.Organi publik, në cdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të cdo kopje të njëhësuar të tij.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat pasi konstatoi se pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

**VENDOSI:**

1. Korrigjimin e gabimit në “Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor, subjekti “KOKA&ERGI ENERGY STAVEC” Sh.p.k në gabimin gjatë zbardhjes së lejes nga “5 vjet” në “sipas afatit të kontratës së koncensionit”.

2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përvec gabimit material.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

